



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:243173

Datë: 22.04.2021

Numri i dokumentit: 01721760

**PKR.NR.284/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësorë Dafina Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. G. nga fshati .....K- ....., për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/II.nr.2041/19 të dt. 07.11.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurories së shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit M. G. dhe mbrojtësit të tij av. P. Zh., me dt. 19.04.2021, mori dhe me 22.04.2021 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:** M. G. , i biri i H. dhe nënës M., e gjinisë D., i lindur me dt. .... në ....., ndërsa tani me vendbanim në fsh. .... K....., i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, posedon nr. tele. ...., i gjendjes së mesme ekonomike, nr. personal ....., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 të KPRK-së **REFUZOHET AKTAKUZA**

**Për shkak se:**

Me parë e gjerë me dt. 25.08.2019, rreth orës 19:00, në fsh ..... K. .... , i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par 1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë një armë-pistoletë me gaz e modelit zoraki 917-t, kaë.9 mm, me nr. serik 0219-00277, 1 (një) karikator, 1(një) gëzhjojë kal. 6.35mm, 1 (një) gëzhjojë kal. 7.62x39 mm, në atë mënyrë që ditën kritike pasi qe Policia e Kosovës kanë marrë informatë se i pandehuri M. G. posedon armë pa leje të njëjtit shkojnë në vendin e lartcekur dhe në pjesën e oborrit të shtëpisë së tij, kanë gjetur gëzhhojat e lartcekura dhe më pas me tu kontaktuar i pandehuri M. G. nga ana e Policisë , ky i fundit merr armën e lartcekur dhe të njëjtën e dorëzon në stacionin policor Klinë,

- Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së.

**KONFFISKOHET** arma-pistoletë me gaz e modelit Zoraki 917-t, kal.9 mm, me nr. serik 0219-00277, 1 (një) karikator, 1(një) gëzhjojë kal. 6.35mm, 1 (një) gëzhjojë kal. 7.62x39 mm, të

cilat gjenden me nr. të rastit 2020-DE-474, ku pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit urdhërohet që të njëjtat të shkatërrohen.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2041/19 të dt.07.11.2019, kundër të akuzuarit M. G. nga fshati .....K- ....., për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se .

Para leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 19.04.2021, prokurorja e shtetit Valbona Disha Haxhosaj, deklaroi se duke u bazuar ne aktvendimin e Gjykatës Themelore ne Peje, PK.nr.269/20 te dt.10.12.2020, me te cilën ka aprovuar kërkesën e parashtruar nga PTH- ne Peje, PP/II.nr. 2041 /2019, te dt. 10.11.2020, për rishikimin e procedure penale, meqenëse veprës penale ne fjalë për periudhën kur është kryer sipas aktgjykimit në fjale me dt. 25.08.2019, është përfshire ne amnisti apo falje sipas vendimit te MPB-se nr. 536 /2018, te dt. 23.12.2018, dhe 18 .06.2019 me te cilin është shpallur afati për legalizim te armëve nga dt. 17 qershor 2019, për te zgjatur gjerë me dt.17.09.2019, ne baze te këtij fakti heki dore nga aktakuza sa i përket veprës penale për te cilën është akuzuar i pandehuri nga neni 366 prg. 1 te KPRK-se, kurse i propozoi Gjykatës qe amët dhe municioni i sekuestruar përkohësisht te konfiskohet dhe te njëjtat pas ekzaminimit te jepet urdhër për shkatërrim.

Mbrojtësja e të akuzuarit av. P. Zh. dhe I akuzuari M. G. nuk e kundërshtuan deklarimin e prokurorës së shtetit dhe u pajtuan për të njejtën.

Gjykata konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së e refuzoi aktakuzën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi qe prokuroria hoqi dorë nga aktakuza PP/II.nr.2041/19 të dt.07.11.2019, kundër të akuzuarit Mujë Gashi për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se

Meqenëse arma e sekuestruar ka qenë pa leje dhe tanimë ka kaluar afati për legalizimin e armëve në posedim, dhe që hyn në grupin e pasurisë- sendeve që i nënshtrohet konfiskimit automatik, paraparë me nenin 282 par.1 dhe 2 pika 2.1,të KPPRK-së, gjykata ka vendosur që të konfiskohet arma konform nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPRK-së

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,  
2019:243173, 22.04.2021**

**Kryetarja e trupit gjykues**

\_\_\_\_\_  
Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.